



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 5617 Prot

Tiranë më 19.12 2019

**VENDIM**

Nr. 57, datë 19.12 2019

Bazuar në ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 38, si dhe në Statutin e UT neni 31, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.12.2019 me tematikë të dedikuar fatkeqësisë natyrore të tërmetit të 26 nëntori 2019, pasi analizoi të gjitha kontributet dhe veprimtarinë e studentëve, strukturave të Universitetit të Tiranës, u solidarizua dhe duke përshëndetur dhe mbështetur edhe vendimin e Bordit të Administrimit për ndihmën e akorduar,

**VENDOSI:**

1. Ngarkohet Rektorati i UT-ës të hartojë një plan veprimi për të vazhduar kontributin e UT-ës në ndihmë të njerëzve në nevojë për përballimin e situatës dhe në veçanti të studentëve, familjeve të prekura, si dhe për ambientet e UT-ës të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntori 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

